



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 318/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Hasan Shala, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit dhe dëmtimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar.

Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptitet dënim i më gjobë në vlerë prej 3200 (tremijedyqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Subjekti politik LDK, ka parashtruar ankesë më te cilën pretendon se subjekti politik PDK, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, sepse subjekti politik PDK, i ka mbuluar posterat e subjektit politik LDK, duke i vendosur posterat e kandidatëve për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik PDK.

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 04.12.2010, nga subjekti politik LDK, në të cilën theksohet subjekti politik PDK i ka mbuluar posterat e subjektit politik LDK, duke i vendosur posterat e kandidatëve për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e PDK-së, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur tri fotografë si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterat e kandidatëve për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik PDK, janë vendosur mbi posterat subjektit politik LDK. Me propozim qe të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik PDK, më datë 05.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, nuk mori përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar.

Veprimet e Ndaluara të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe nenit 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojnë nga bërja e ndonjërisë si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë rjoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjeter i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjeter politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të rajoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posterat e kandidatëve për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik PDK, janë vendosur mbi posterat subjektit politik LDK. Prandaj nga këto arsyë dhe me qëllim të evitimit të shkeljes së lartcekur e në pajtim më dispozitat e lartcekura ligjore, PZAP-i vlerëson se

ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 318/2010 më datën 06.12.2010

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

